

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

2.1.2 Vlerësimi i punës në bërë në Llogaritë Kombëtare
Komponenti nr. 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Clementina Ivan-Ungureanu dhe Timmi Graversen
Statistikat e Danimarkës

1-5 Shkurt 2016

IPA 2012

Clementina Ivan-Ungureanu
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +
Email: iu_clem@yahoo.com

Timmi Graversen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 38 65
Email: trg@dst.dk

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme	5
2. Vlerësimet dhe rezultatet	5
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	91
Aneksi 1. Termat e Referencës	11
Aneksi 2. Personat e takuar	15

Lista e Shkurtesave

ANA	Llogaritë Kombëtare Vjetore
ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
IPA	Instrumenti Para Asociim-Stabilizimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
LLKT	Llogaritë Kombëtare Tremujore
BPVT	BPV Tremujor
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
NOE	Ekonomia e pavrojtuar
R& D	Kërkimi dhe Zhvillimi
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Nderkombëtar
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruse-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Përmbledhje Ekzekutive

Misioni i mbajtur në komponentin 2 – Llogaritë Kombëtare - të projektit të binjakëzimit në periudhën 1-5 Shkurt 2016, si objektiv kryesor ka pasur vlerësimin e gjendjes në Llogaritë Kombëtare në Kosovë, analizimin e qëndrueshmërisë së rezultateve të arritura në kuadër të projektit të binjakëzimit dhe diskutimi i planit të veprimit pas përfundimit të projektit (në fund të Shkurtit 2016).

Plani i veprimit për projektin e binjakëzimit 2014-15 është hartuar duke marrë parasysh objektivat e ASK-së, burimet njerëzore dhe projektet e tjera, që kanë qenë duke u zhvilluar në vazhdim (projektet IPA), dhe objektivat e binjakëzimit. Arritjet e këtyre qëllimeve janë varur jo vetëm nga zhvillimi i llogarive kombëtare, por edhe nga progresi i fushave të tjera statistikore, siç janë statistikat strukturore dhe afatshkurta, çmimet, statistikat sociale (Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare) dhe qasja në burimet e të dhënave administrative. Si rezultat i nënshkrimit të një Memorandumi Mirëkuptimi midis ASK-së dhe ATK-së, në qershor të vitit 2014, ka pasur të dhëna mjaftueshëm të detajuara, cilësore dhe me kohë, të nevojshme për përpilimin e llogarive kombëtare.

Plani i veprimit i hartuar ka qenë shumë ambicioz, por ASK ka realizuar një aktivitet të qëndrueshëm dhe, me përkrahjen nga projekti, është impresionuese arritja e një pjese të madhe të objektivave të propozuara. Është realizuar ESA 2010 dhe është konvertuar klasifikimi i industrive nga NACE rev.1 në NACE rev.2. Gjithashtu, në fund të vitit 2014 janë publikuar seritë kohore të rishikuara të llogarive kombëtare për periudhën 2008-2013. Një arritje e rëndësishme është realizimi i BPV tremujore (BPVT), sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante. Rezultatet e para për periudhën 2010-tremujori i parë 2014 janë publikuar në Dhjetor të vitit 2014. Ky aktivitet ka vazhduar me vlerësimet e përkohshme të BPV vjetore 2014, si shumë e tremujorëve, që ka përfunduar në Qershor të vitit 2015. Këto vlerësime, të analizuara në raport me versionin final të BPV vjetore 2014 (të publikuara në Nëntor 2015) kanë konfirmuar që të dhënat tremujore kanë ofruar rezultate mjaft konsistente. SUT 2013 në çmime aktuale pritet të finalizohet deri në fund të projektit dhe do të përbëjnë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të llogarive kombëtare.

Dy objektivat e projektit të binjakëzimit në fushën e llogarive kombëtare ka mbetur të realizohen në të ardhmen: vlerësimi i Ekonomisë së Pavrojtuar dhe përpilimi i SUT 2014, në çmime aktuale dhe konstante. Është elaboruar një plan i detajuar veprimi në fund të vitit 2013, për vlerësimin e llojeve të ekonomisë së pavrojtuar dhe integritet të tyre në llogaritë kombëtare. Fatkeqësisht, për shkak të mungesës së financave, këto objektiva nuk janë arritur.

Sistemi i llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore i zhvilluar në kuadër të projektit të binjakëzimit, duhet të konsolidohet dhe të përmirësohet në të ardhmen, në mënyrë që të plotësohen kërkesat e programit të transmetimit ESA 2010 (veçanërisht speciale 1, 2 dhe 3).

1. Komentet e përgjithshme

Raporti i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit ‘Përkrahje për Statistikat e Kosovës’. Qëllimi i misionit ka qenë vlerësimi i rezultateve të projektit dhe hartimi i një plani të veprimit për zhvillim të mëtejshëm në fushën e llogarive kombëtare.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Vlerësimi i gjendjes në Llogaritë Kombëtare në Kosovë
- Analizimi i qëndrueshmërisë së rezultateve të Binjakëzimit
- Diskutimi i planit të veprimit për ASK-në, pas Binjakëzimit

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve të tjerë (NI-CO/Statistikat e Finlandës/Istat/Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Gjatë misionit, ekspertët kanë diskutuar rezultatet e projektit me stafin e menaxhmentit të Departamentit të Llogarive Kombëtare.

Përpilimi i integruar dhe sistemi i publikimit të BPV vjetore sipas qasjes së shpenzimeve dhe prodhimit, në çmime aktuale dhe konstante, si dhe Llogaritë Kombëtare tremujore, kanë filluar të realizohen, si pjesë e planit të punës të ASK-së për vitin 2015, në kuadër të projektit të binjakëzimit.

Për herë të parë, në Nëntor të vitit 2015, ASK ka publikuar BPV vjetore, sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve në të njëjtën kohë, në çmime aktuale dhe konstante. Vlerësimet e BPV tremujore janë publikuar në mënyrë të rregullt, duke filluar me tremujorin e parë të vitit 2014, në Dhjetor të vitit 2015; tremujori i tretë 2015 do të publikohet në gjysmën e parë të Shkurtit 2016, përfshirë rishikimet e tremujoreve 2014, të krahasuara me vlerësimet vjetore.

Plani i punës dhe arritjet e realizuara në llogaritë kombëtare në kuadër të projektit të binjakëzimit janë paraqitur në tabelën 1.

Vlerësimet e para të BPVT sipas qasjes së prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, do të publikohen në fillim të Dhjetorit 2014; ky aktivitet do të vazhdojë në vitin e ardhshëm dhe në Qershor të vitit 2015 do të jetë në dispozicion versioni i parë i BPV vjetore, si shumë e tremujorëve, sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve. Në të njëjtën kohë, është parashikuar të elaborohet dhe publikohet versioni gjysëm final i BPV vjetore 2014 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në të njëjtën kohë, në Nëntor të vitit 2015.

Tabela1.Të arritura të planit të veprimit

Aktiviteti 1. Përmirësimi i LLogarive Kombëtare Vjetore (ANA)

Kosova ka filluar implementimin e ESA 2010, në kuadër të projektit IPA 2011 (gjatë periudhës 2013-2014). Është hartuar harta rrugore për implementimin e metodologjisë së re dhe aktiviteti është fokusuar në temat në vijim:

- Kufirin e prodhimit: kërkimi dhe zhvillimi (R&D),
- FISIM dhe alokimi i tij në mes përdoruesve
- Outputi i Bankës Qendrore dhe sigurimi jo-jetësor
- Asetet jo-financiare: sistemi i armëve.

Ndryshimet e tjera të kërkuara sipas ESA 2010 janë konsideruar ose jo relevante për ekonominë e Kosovës, ose, për shkak të burimeve njerëzore të kufizuara në ASK, implementimi i tyre nuk është i mundur në periudhën e ardhshme.

Krahas implementimit të ESA 2010, ka filluar edhe rishikimi i të dhënave vjetore në kuadër të kornizës së projektit të FMN-së, sa i përket vlerësimit të: (i) outputit dhe konsumit të ndërmjetëm të njësive jo-financiare; (ii) outputit të qeverisë (përfshirë metodën e re për kalkulimin e SHKF), (iii) Shpeznimet e Konsumit Final të Ekonomisë Familjare (SHKFEF) (iv) qerasë së përlllogaritur/supozuar duke përdorur qasjen e kostos së përdoruesit bazuar në të dhënat e ofruara nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave dhe (v) outputit të qeverisë në çmime konstante dhe taksat në produkte.

Projektet IPA dhe FMN kanë qenë duke u realizuar në kohën kur ka filluar projekti i Binjakëzimit në vitin 2014. Kompletimi i këtyre projekteve është përfshirë në planifikimin e projektit të Binjakëzimit.

ASK ka implementuar klasifikimin e ri të aktiviteteve, NACE rev.2. Është mbajtur një anketë e veçantë në vitin 2013 për 27000 njësi, në mënyrë që të krijohet një tabelë korresponduese midis NACE rev.1 dhe NACE rev.2. Bazuar në kushtet e vendit dhe rezultatet e anketës, është realizuar një tabelë tranzicioni nga Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe ka qenë në dispozicion në fund të Gushtit 2014. Kjo tabelë konvertimi është përdorur nga DLLK, për vlerësimin e outputit dhe konsumit të ndërmjetëm sipas aktivitetit, bazuar në NACE rev.2. Vlerësimet janë realizuar për periudhën 2008-2013 dhe janë publikuar në fund të Nëntorit 2014.

Aktualisht, seritë kohore të BPV vjetore sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, bazuar në metodologjinë ESA 2010, janë në dispozicion për periudhën 2008-2014. Duhet të theksohet fakti që ASK ka eliminuar hapësirën kohore midis publikimit të BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve; në Nëntor 2015, për herë të parë, vlerësimet e BPV-së sipas dy qasjeve janë integruar, balancuar dhe publikuar së bashku. Kjo arritje është integruar në procesin e përpilimit dhe në kalendarin e publikimeve për 2016, publikimi i BPV-së sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante është planifikuar për 3 nëntor 2016.

Aktiviteti 2. BPV Tremujore

Me përkrahjen e projektit të binjakëzimit, ASK ka realizuar llogaritë kombëtare tremujore. Procesi i implementimit ka filluar me vlerësimin e BPVT sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve për vitet 2010-2013, për të cilat ka pasur në dispozicion të dhëna vjetore.

Vlerësimet e BPVT janë realizuar, bazuar në burimet e të dhënave statistikore dhe administrative në dispozicion, siç janë: qarkullimi për qëllime të TVSH-së nga ATK, pasqyrat financiare të njësive financiare (Banka Qendrore, bankat e tjera komerciale dhe kompanitë e sigurimit), shpenzimet qeveritare dhe të ardhurat të ofruara nga Ministria e Financave, të dhënat e bilancit të Pagesave (BoP) të ofruara nga Banka Qendrore dhe çmimet e grumbulluara nga ASK (Indeksi i Çmimit të prodhimit (IÇP), Indeksi i Çmimit të Konsumit (IÇK) dhe çmimet e outputit dhe inputit në bujqësi).

Objektivat kryesore të planit të punës të zhvilluar në kuadër të projektit janë arritur, dhe vlerësimet e para të BPVT për periudhën 2010- tremujori i parë 2014, bazuar në metodologjinë ESA 2010 sipas qasjeve të prodhimit dhe shpenzimeve, në çmime aktuale dhe konstante, janë diseminuar në Dhjetor të vitit 2014. Ky aktivitet ka vazhduar dhe BPV vjetore si shumë e tremujorëve është publikuar në Qershor të vitit 2015. BPV vjetore 2014, i hartuar duke përdorur burimet e të dhënave vjetore, është publikuar në Nëntor të vitit 2015. Diferencat midis vlerësimeve vjetore dhe tremujore nuk kanë qenë sinjifikante (në terma nominalë, BPV vjetore ka qenë më e lartë se shuma e tremujorëve për 1.5% dhe shkalla e rritjes reale për 0.3%) dhe këto diferenca kanë qenë për shkak të ndryshimit të metodologjisë në përdorimin e burimit të dhënave. Rezultatet e marra për vitin 2014 vërtetojnë që metodologjia e vendosur për përpilimin e BPVT ofron vlerësime të besueshme.

Të dhënat tremujore për vitin 2014 janë rishikuar dhe krahasuar me rezultatet vjetore; të dhënat e reja, së bashku me rishikimin e dy tremujoreve të parë të vitit 2015, janë publikuar me 12 Shkurt të vitit 2016.

Aktiviteti 3 – Elaborimi i tabelave Ofruese përdoruese (SUT)

SUT përfaqëson një mjet të rëndësishëm për përmirësimin e llogarive kombëtare në baza tremujore dhe vjetore. Për këtë arsye, në kuadër të projektit të binjakëzimit ka filluar përpilimi i SUT për vitin 2013. Është vendosur korniza e SUT dhe janë bërë kalkulime të detajuara; konsistenca e tabelave do të sigurohet për NACE rev.2 në nivel 2 shifror dhe CPA në nivel 2 shifror.

Disa aktivitete janë mbajtur gjatë vitit 2015 me fokus grumbullimin e të dhënave, kodifikimin e informatave dhe integrimin e indikatorëve në strukturën SUT. Një mision më i gjatë do të zhvillohet nga fundi i projektit për finalizimin e anës ofruese dhe përdoruese dhe për balancimin e sistemit.

Mund të konsiderohet që një pjesë e objektivave të planifikuara për këtë komponent do të arrihen. Në procesin e përpilimit të SUT, ekipi është ballafaquar me probleme të papritura dhe punë shtesë, për shkak të cilësisë së dobët dhe mos- konsistencës së disa të dhënave nga burime të ndryshme (sidomos ASN dhe PRODCOM). Për këtë arsye, përpilimi i SUT 2014

nuk ka qenë i mundur të realizohet gjatë këtij projekti. Kjo detyrë ndoshta mund të arrihet nga ASK, duke përcjellë kornizën dhe procedurën e përpilimit të vendosur për vitin 2013.

Aktiviteti 4. Përmirësimi i metodologjisë dhe matjeve statistikore të ekonomisë së pavrojtuar (NOE)

ASK, me përkrahjen e IPA 2011, në fund të vitit 2013, ka hartuar një plan veprimi për vlerësimin e ekonomisë të pavrojtuar bazuar në qasjen tabelore të Eurostat-it. Për vlerësimin e llojeve të ekonomisë së pavrojtuar (N1 Deri N6), plani i veprimit ka propozuar disa anketa me ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare. ASK ka shikuar të gjejë përkrahje financiare nga donatorë të ndryshëm, por nuk ka pasur rezultat. Në këto kushte, BPV vjetore dhe tremujore përfshijnë vlerësime mbi ekonominë e pavrojtuar.

3. Qëndrueshmëria


Rezultatet e divizionit të LLK janë impulsive. Ata kanë arritur të prodhojnë versionet e planifikuara të Llogarive Kombëtare tremujore dhe vjetore, gjatë vitit 2015. Stafit duket konfident në vazhdimin e rregullt të prodhimit të Llogarive Kombëtare siaps planit të vitit 2016.


Kapaciteti për të zgjeruar aktivitetin do të jetë i limituar. Numri i stafit është zvogëluar afërsisht në të njëjtën kohë me përfundimin e projektit të binjakëzimit, dhe aktualisht nuk ka ndonjë plan për përkrahjen e zhvillimit të LLK në Kosovë.

SUT pritet të balancohet dhe kompletohet në fillim të Marsit. Nuk është e nevojshme të përpilohet SUT për secilin vit, prandaj duhet të vlerësohet me kujdes nëse është e mundur të vazhdohet me përpilimin e SUT për vitin 2014. Kjo duhet të peshohet në raport me avantazhet e mundshme nga ky aktivitet. Po ashtu, përvoja e fituar në procesimin e ASN për qëllime të Llogarive Kombëtare do të jetë shumë e vlefshme për ASK-në.

Në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, divizioni i LLK duhet të fokusohet në konsolidimin e rezultateve të arritura. Të vazhdohet me prodhimin e rregullt të Llogarive Kombëtare sipas orarit dhe me përmirësimin e saktësisë dhe besueshmërisë të rezultateve, duke integruar burimet e reja të të dhënave dhe metodave në mënyrë të vazhdueshme.

Nga viti 2016, ASK pritet të publikojë rezultatet e para vjetore për t-1 me llogaritë kombëtare tremujore për tremujorin e 4-të të vitit 2015, në Maj të vitit 2016. Rezultatet vjetore të rishikuara për vitin 2015 bazuar në ASN 2015 do të publikohen në Nëntor të vitit 2016. ASK pret të reduktojë gradualisht periudhën e përpilimit për LLKT dhe planifikon të publikojë LLKT për tremujorin e 3-të të vitit 2016 me vonesë vetëm prej tre muajsh, në fund të Dhjetorit të vitit 2016.





Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria, ASK duhet të fokusohet në **konsolidimin** e rezultateve të arriturave gjatë projektit të binjakëzimit. Aktivitetet kryesore që duhet të vazhdojnë janë:

- Të ruhet rutina në procedurat e kalkulimit dhe të vazhdohet përmirësimi i burimeve të të dhënave dhe metodave në sistemin e krijuar;
- Të organizohet ruajtja e të dhënave në sistemin e Llogarive Kombëtare, në mënyrë që versionet e llogarive tremujore dhe vjetore të trajtohen në mënyrë sistematike (në parim secili version duhet të jetë i ripordhueshëm);
- Të zhvillohen procedurat për trajtimin e ndërhyrjeve të përdoruesve dhe bashkëpunimi me subjektet relevante, siç është Banka Qendrore dhe Ministria e Financave;
- Të zhvillohet politika e rishikimit dhe të trajtohen nivelet e reja referuese, siç është SUT 2013;
- Të kompletohet tabela 1 e programit të transmetimit ESA 2010;
- Të fillohet me përshtatjet sezonale në llogaritë kombëtare tremujore;
- Të përmirësohen vlerësimet e ekonomisë së pavrojtuar dhe të njejtat të integrohen në llogaritë kombëtare.

4. Konkluzionet dhe rekomandimet

Mund të konkludohet që objektivat e projektit të binjakëzimit janë arritur dhe dy vitet e fundit janë realizuar zhvillime të konsiderueshme në llogaritë kombëtare.

Rekomandohet fuqishëm të konsolidohet sistemi i ndërtuar duke përmirësuar burimet e të dhënave statistikore në aspektin e përmbajtjes, afatit të diseminimit dhe të përpilohet një politike rishikimi, e dakorduar me përdoruesit kryesorë.

Aneksi 1. Termat e Referencës



Projekti i Binjakëzimit i BE-së KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Përkrahje për Statistikat

Termat e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare

Aktiviteti 2.1.2: Vlerësimi i punës së bërë në Llogaritë Kombëtare

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 18 Janar 2016

Fillimi / fund i aktivitetit: 1-5 Shkurt 2016

Raportimi: 12 Shkurt 2016

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.1.1 2.1.2	Vlerësimi dhe azhurnimi i planit të veprimit Vlerësimi i punës së bërë gjatë projektit të Binjakëzimit	- Raporti i misionit i publikuar në faqen e internetit të projektit - Plani i veprimit i azhurnuar për Llogaritë Kombëtare në Kosovë, përfshirë planin operacional/programimin e aktiviteteve të zhvilluara në 2.2 - Vlerësimi i standardeve për LLK	- Raportet tremujore të Projektit të Binjakëzimit - Raporti i Misionit - Plani i veprimit, i azhurnuar	- Kapaciteti i mjaftueshëm absorbimi - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në statistika primare të qarta - Termat e reference

				s, te perpiluar a me kohe, qe paraqesin ne detaje detyrat, (inputi), rezultat e pritura, pjesëmarr ësit ne aktivitet dhe agjendën
--	--	--	--	---

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 2.1.2

Konsultimet dhe diskutimet me njësinë e Llogarive kombëtare. Në fund të Binjakëzimit, kontrollimi dhe vlerësimi i gjendjes të Llogarive Kombëtare në Kosovë. Më tej, të vlerësohet qëndrueshmëria afatshkurtër dhe afatmesme e ASK-së për të prodhuar dhe publikuar të dhënat e LLK dhe LLKT pas Binjakëzimit.

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.1.2:

Raporti i misionit. Paraqitja e rezultateve të vlerësimit dhe krahasimi i rezultateve me rezultatet obligative të pritura. Më tej, komentimi i secilit rezultat obligativ për LLK, LLKT dhe SUT.

Rezultatet obligative të Komponentit 2, LLK, projekti i Binjakëzimit ASK:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet
2.1	Rritja e pajtueshmërisë me ESA 2010, përfshirë përmirësimet në vlerësimin e prodhimit, konsumit të ndërmjetëm dhe vlerës së shtuar për të gjitha aktivitetet e ekonomisë.	- Metodologjia e përmirësuar për Llogaritë Kombëtare në përputhje me ESA 2010 deri në tremujorin e 8-të të projektit - Metodologjia për prodhimin e BPV vjetore sipas prodhimit dhe shpenzimeve, të përmirësuara deri në tremujorin e 8-të të projektit.
2.2	Vlerësimi i Llogarive Kombëtare në çmimet konstante, bazuar në indekset e përmirësuar të çmimit	Metodologjia për vlerësimin e Llogarive Kombëtare, në çmime konstante të përmirësuara në deri në tremujorin e 8-të të projektit

2.3	Rezultati obligativ 2.3 i shtuar nga shtojca #1: Mbulimi dhe relevanca e përmirësuar e Llogarive Kombëtare dhe cilësia e përmirësuar e të dhënave primare, e përdorur për përpilimin e Llogarive Kombëtare, përmes përgatitjes së SUT (Tabela ofruese përdoruese)	• Studimi i fizibilitetit për përpilimin e SUT për Kosovë, i përgatitur deri në tremujorin e 8-të të projektit • Pasi që studimi i fizibilitetit ka rezultuar pozitiv, konsulentët dhe ASK kanë vazhduar punën në SUT. Kjo punë do të vazhdojë deri në fund të projektit të Binjakëzimit
-----	---	---

Resurset e ASK-së:

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, Xhevdie.Fetahu@rks-gov.net

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ilir.Mazrekaj@rks-gov.net

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Emine.Bajrami@rks-gov.net

Florije Krapit, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapit@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Nysret.Sylejmani@rks-gov.net

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Ekipi i Projektit të Binjakëzimit i ASK-së:

Udhëheqës i Projektit në ASK, Z. Ilir T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Homologu i RTA, Znj. Teuta Zyberi, Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë, teuta.zyberi@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Clementina Ivan-Ungureanu, Ekspert, Statistikat e Danimarkës, iu_clem@yahoo.com

Mr Timmi Roelle Gravesen, Ekspert i Llogarive Kombëtare, Statistikat e Danimarkës, trg@dst.dk

Resurset e Projektit të Binjakëzimit:

Mr Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Ms Nora Zogaj, RTA asistente, zogaj.nora@gmail.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Deri në fund të tremujorit janë përfunduar 15 misione të Binjakëzimit mbi Llogaritë Kombëtare dhe Llogaritë Kombëtare Tremujore.

Gjatë misionit të parë në Janar 2014 dhe 2012 është diskutuar Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global (AGA) i përgatitur nga Eurostat. AGA deklaroi si në vijim në lidhje me Llogaritë Kombëtare: *Në vitin 2010 ASK së bashku me IPA ka përgatitur 'Planin e Veprimit për përpilimin dhe publikimin e statistikave të përgjithshme mbi Llogaritë Kombëtare dhe tregun e punës'. Ky plan në princip është instrument i dobishëm për të organizuar zhvillimin Llogarive Kombëtare në të ardhmen, së bashku me zhvillimin e*

standardeve dhe burimeve që nevojiten për rritjen e mbulimit dhe përmirësimin e të dhënave të Llogarive Kombëtare. Megjithatë, duket që Plani i Veprimit tani më ka nevojë për një azhurnim total për të përmbushur aktivitetet.

Prandaj projekti i Binjakëzimit, ka dedikuar misionin e parë mbi Llogaritë Kombëtare për azhurnimin e planit të veprimit dhe plotësimin e planit të veprimit me një plan operacional afat mesëm. Aktiviteti është mbajtur nga të njejtët ekspertë, të cilët e udhëheqin misionin aktual. Gjatë misionit në Janar të vitit 2014 është rishikuar plani i veprimit (shih më poshtë raportin e përmendur)

Aktivitetet që duhet ndërmerren si përgatitjet për misionin:

- Raporti mbi Misionin 2.1.1 Vlerësimi dhe azhurnimi i planit të veprimit (Ivan-Ungureanu, Statistikat e Danimarkës dhe Timmi Graversen, Statistikat e Danimarkës)
- Të gjitha raportet e misionit mbi LLK dhe LLKT janë në dispozicion në dts.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Vlerësimi i gjendjes të Llogarive Kombëtare në Kosovë
- Analizimi i qëndrueshmërisë të rezultateve të Binjakëzimit
- Diskutimi i planit të veprimit pas Binjakëzimit

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Plani për ASK, për të siguruar qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura në kuadër të Binjakëzimit në LLK
- Lista e rezultateve të arritura nga Binjakëzimi krahasuar me rezultatet obligative

Aneksi 1. Programi - 1-5 Shkurt 2016

Dita	Koha	Aktiviteti
1	10:00	Planifikimi i javës dhe programi Konsultimet me personat kyç
2	09:00- 16:00	Analizimi i aktiviteteve të mbajtura dhe rezultateve të fituara
3	09:00- 16:00	Analizimi i aktiviteteve të mbajtura dhe rezultateve të fituara
4	09:00- 16:00	Diskutimi i aktiviteteve të ardhshme
5	09:00- 16:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Llogaritë Kombëtare

Ilir Berisha, Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare,

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare

Ylli Shala, Ilir Mazrekaj, Emine Bajrami Florije Krap, Nysret Sylejmani, Besim Mehmeti

ASN dhe regjistri i bizneseve

Hysni Elshani, Shef Sektori në Statistikat e Biznesit dhe Muhamet Kastrati, ekspert

RTA Team:

Per Knudsen, RTA (Resident Twinning Adviser)

Nora Zogaj, Asistente e RTA